



R A P O R T

I

AUDITUESIT TE PAVARUR

Dhe Pasqyrat Financiare

Te SHOQERISE

KLUBI I FUTBOLLIT "TEUTA" DURRES

PER PERIUDHEN

1 Janar – 31 Dhjetor 2024

***Drejtuar :* Perfaqsesit ligjore te KLUBI I FUTBOLLIT "TEUTA"**

Altin SULEJMANI

1

Nuis: L42025504A, Lic. nr.345, dt.16/01/2015,

Adrese: Sheshi "Liria", EGT Center, Nr.24, Zip Code: 2001, Durres, Albania, Cel: ++355 692065752, www.sulejmani.al

OPINIONI

Une kam audituar Pasqyrat Financiare te shoqërisë **KLUBI I FUTBOLLIT "TEUTA"**, te cilat perfshijne: Pasqyren e Pozicionit Financiar te dates 31 Dhjetor 2024, Pasqyren e Te Ardhurave Gjithperfshirese (Pasqyra e Performances), Pasqyra e Ndryshimeve ne Kapitalin Neto dhe Pasqyren e Fluksit te mjeteve monetare per vitin e perfunduar ne kete date dhe Shenimet shpjeguese, si dhe nje permbledhje te metodave te rendesishme kontabel dhe shenimeve te tjera anekse.

Sipas opinionit tone, Pasqyrat Financiare bashkangjitur, japin nje pamje te vertete dhe te besueshme, te pozicionit financiar te Subjektit **"KLUBI I FUTBOLLIT TEUTA"** me date **31 Dhjetor 2024**, si dhe te performances financiare dhe pasqyres se flukseve te parase per ushtrimin e mbyllur ne ate date, ne perputhje me Standardet Kombetare te Kontabilitetit (SKK) si dhe Standartit Kombetar te Kontabilitetit per OJF-te.

BAZA PER OPINION :

Une e kam kryer auditimin tim ne perputhje me Standartet Nderkombetare te Auditimit (SNA). Pergjegjesia ime sipas ketyre standarteve eshte pershkruar ne paragrafin *"Pergjegjesite e Auditorit per Auditimin e Pasqyrave Financiare"* te shprehur ne kete Raport. Une jam e pavarur nga shoqeria qe auditoj në përputhje me kërkesat etike që janë të zbatueshme për auditimin e pasqyrave financiare në Shqiperi dhe kam përmbushur përgjegjësitë e tjera etike në përputhje me këto kërkesa.

Une besoj se evidenca e auditimit qe kam marre eshte e mjaftueshme dhe e pershtatshme per te dhene opinionin tim te auditimit.

CESHTJET KRYESORE TE AUDITIMIT :

Çështjet Kryesore te Auditimit jane ato çështje qe, nen gjykimin tim profesional, ishin me te rendesishmet gjate auditimit te pasqyrave financiare te periudhes aktuale. Keto çështje jane adresuar ne kontekstin e auditimit te pasqyrave financiare ne teresi dhe gjate formimit te opinionit tim, per rrjedhoje, dhe une nuk jap nje opinion te veçante per keto çështje.

PERGJEGJESITE E DREJTIMIT DHE TE ATYRE QE JANE NGARKUAR ME QEVERISJEN PER PASQYRAT FINANCIARE :

Altin SULEJMANI

2

Nulis: L42025504A, Llc. nr.345, dt.16/01/2015,

Adrese: Sheshi "Liria", EGT Center, Nr.24, Zip Code: 2001, Durrës, Albania, Cel: ++355 692065752, www.sulejmani.al



Drejtimi eshte pergjegjes per pergatitjen dhe paraqitjen e drejte te ketyre pasqyrave financiare ne perputhje me Standartet Kombetare te Kontabilitetit (SKK) dhe per ato kontrole te brendshme qe drejtimi i gjykon te nevojshme per te bere te mundur pergatitjen e pasqyrave financiare qe nuk permbajne anomali material, qofte per shkak mashtrimi apo gabimi.

Ne pergatitjen e Pasqyrave Financiare, Drejtimi eshte pergjegjes per vleresimin e aftesise se vijueshmerise se shoqerise, duke paraqitur nese eshte rasti, çeshtje te lidhura me vijueshmerine dhe te perdore parimin e vijueshmerise vetem neqoftese ne te kundert, Drejtimi ka per qellim te likujdoje shoqerine ose te nderprese veprimtarine, ose nuk ka alternative realiste per te vazhduar.

Te ngarkuarit me Qeverisjen jane pergjegjjes per mbikqyrjen e procesit te raportimit financiar te Shoqerise.

PERGJEGJESIA E AUDITUESIT :

Objektivat tona jane per te arritur sigurine e arsyeshme, per faktin nese pasqyrat financiare jane pa anomali materiale, qofte per shkak mashtrimi apo gabimi dhe perpilimi i raportit te auditimit qe permban opinionin tone. Siguri e arsyeshme eshte nje nivel i larte sigurie, por nuk eshte garanci qe nje auditim i kryer ne perputhje me Standartet Nderkombetare te Auditimit do te zbuloje nje anomali materiale kur ajo ekziston. Anomalit mund te rezultojne nga mashtrimi ose gabimi dhe konsiderohen materiale neqoftese, individualisht ose ne total, pritet qe ato mund te kene ndikim ne vendimet ekonomike te perdoruesve, te marra duke u bazuar ne keto pasqyra financiare.

RAPORT PER KERKESAT E TJERA LIGJORE DHE RREGULLATORE :

Ne angazhimin tim per auditimin e Pasqyrave Financiare te shoqerise **KLUBI I FUTBOLLIT "TEUTA"**, nuk ka kerkesa te tjera nga ana e Drejtimit per tu raportuar nga une.

Audituesi qe ka pergatitur kete raport auditimi te pavarur eshte :


Durres me, 24.03.2025



Altin SULEJMANI

Auditues i Pavarur

ALTIN SULEJMANI



3

Nuis: L42025504A, Lic. nr.345, dt.16/01/2015,

Adrese: Sheshi "Liria", EGT Center, Nr.24, Zip Code: 2001, Durres, Albania, Cel: ++355 692065752, www.sulejmani.al